REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 146/17
Datë/Datum. 27-06-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 146/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina- Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "New –Line "Sh.p.k.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat kuzhinës të institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. PR 616/16/169/111, iniciuar nga AK-KK /Komuna Prishtinës/ më datën 16.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "New –Line "Sh.p.k.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat kuzhinës të institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. PR 616/16/169/111, iniciuar nga AK-KK /Komuna Prishtinës/.

II. **Vërtetohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së KK / Komuna Prishtinë/, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat kuzhinës të institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. PR 616/16/169/111,

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "New Line"- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:30.11.2016

Hapja e ofertave është bërë me dt:27.12.2016, ku kanë marr pjesë gjashtë operator ekonomik.

Njoftimi i për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:18.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Hajdini Comerce"- Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Neë –Line "Sh.p.k.-Prishtinë, me dt: 20.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "New –Line "Sh.p.k.-Prishtinë,

Operatori ekonomik ankues "New –Line "Sh.p.k.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 18 Maj 2017 me nr. 146/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat

kuzhinës të institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. PR 616/16/169/111, iniciuar nga AK-KK /Komuna Prishtinës/
duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 - Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
- Neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës;
- Rregullat për çmime Jo-Normalisht të ulëta.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 24.05.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 29.05.2017, bazuar në sqarimet e cekura në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë", me numër të prokurimit: PR 616/16/169/111, i ka respektuar dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe njëherit propozon që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 30.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet plotësisht me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 30.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.06.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së,vëzhgues nga D Plus Sara Zhubi u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues: OE:"Neë Line" z. Bajraktaraj ka deklaruar :Fillimisht komisioni pranë AK na ka njoftuar se kemi çmim jo normalisht të ulët. Pas analizës së ofertës së ofertës kemi vërejt se është aj çmim dhe se aty është gabim teknik, fjala është për çmimi 7 euro ndërsa është shënuar 0.7€. Ne kemi njoftuar dhe kemi deklaruar se ka qenë gabim teknike, mirëpo edhe me atë artikull të lirë mund të bëjmë furnizim. AK ka kërkuar një lloj garancioni dhe kemi deklaruar se edhe pse vlera sigurimit 10%, ne jemi në gjendje të rrisim vlerën e sigurimit. Vlera është bërë 20% dhe kemi pranuar këtë rekomandim të tyre, dhe kemi bërë sigurimin e ekzekutimit , polisën e sigurimit dhe jemi shpall fitues.

Pas një kohë jemi njoftuar se ka bërë ankesë një OE Hajdini Comerc dhe është pezulluar shqyrtimi. Komisioni i ka kthyer përgjigje negative OE dhe pastaj është bërë ankesë në OSHP. Eksperti i OSHP-së po ashtu e ka vlerësuar ankesën të pabazë. Në seancë të OSHP-së, paneli shqyrtues ka marr një vendim kundër vendimit të AK dhe eksperti shqyrtues dhe ka kthyer lëndën në rivlerësim në bazë të rregullores 57 pika 4.4 dhe 4.5. Në rastin konkret janë pozicione tjera me të cilat ne mbulojmë shpenzimet tona dhe pozicioni me çmim 0.7€ është çmim realisht i ulët mirëpo është për një furnizim jo të madh rreth 400 kg dhe është i përballueshëm.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues ka deklaruar :OE ankues në ankesën e tij e po ashtu edhe në seancë sot pranon se ka qenë një gabim, andaj po ju sqaroj se sipas nenit 41.10 pika B e UOPP-së, thuhet se "Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tillë do të refuzohet dhe do konsiderohet si i tërhequr". Duke u bazuar në këtë sqarim i kam propozuar panelit shqyrtues të refuzohet ankesa dhe të vërtetohet vendimi i AK-së.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z. Bajraktari deklaroj: Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 29.05.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk është bindur me sqarimet e dhëna nga operatori ekonomik ankues përkitazi me çmimet e ofruara konkretisht me çmimin prej 0.70 cent për mish viçi të freskët/kg të kërkuar në pozicionin 47 të paramasës. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues konform nenit 61 paragrafi 4 të LPP-së e ka refuzuar tenderin e OE ankues, pasi që konform nenit 61 të LPP-së është e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që pas marrjes së shpjegimeve nga ana e

operatorëve ekonomik të konsideroj një tender më çmim jo normalisht të ulët. Prandaj pretendimi i OE ankues nuk është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh se OE ankues në ankesën e tij e po ashtu edhe në seancë e pranon se ka qenë një gabim, andaj sipas nenit 41.10 pika B e UOPP-së, thuhet se "Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tillë do të refuzohet dhe do konsiderohet si i tërhequr".

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh se kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt:20.04.2017 ndërsa vendimi për refuzim të kësaj kërkese është bërë jashtë afatit të paraparë ligjor dhe për këtë arsye paneli shqyrtues ka ardh në përfundim se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z.Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK "Komuna Prishtinë"

1x1 OE "New –Line "Sh.p.k.-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.